

# HISTORIKU I SHKOLLËS

## RETROSPEKTIVË E ZHVILLIMIT TË SHKOLLËS SONË

Në gjysmën e dytë të shek. **XIX**, saktësisht në vitin **1866** nisnin hapat e parë të edukimit dhe arsimimit fillorë në Lipjan dhe në disa fshatra të komunës sonë.

Për një kohë të gjatë mësimi ishte fetar dhe zhvillohej në mejtepe, kryesisht në gjuhën turke dhe arabe. Mundësitë e shqiptarëve për t'i vijuar mësimet në këto shkolla (mejtepe) ishin tejet të kufizuara, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike të popullatës, mungesës së kuadrit arsimor, mësimi në gjuhën joamtare, mungesës së mjeteve më elementare për punë etj.

Këto formate shkollimi zgjaten deri në fillimin e luftërave Ballkanike, ku atëherë puna e shkollave u rëndua edhe më shumë, kurse në vitin **1915** gjatë luftës së Parë Botërore vie deri te ndërprerja e plotë e punës në shkollë.

Me përfundimin e luftës së Parë Botërore, saktësisht në vitin **1918** filloi riorganizimi i punës në shkollë. Por, pushteti i atëhershëm nuk ishte i interesuar për shkollimin e fëmijëve shqiptarë dhe lejohej vetëm mësimi në gjuhën serbe. Edhe për kundra kësaj në shkollë u regjistruan edhe disa nxënës shqiptarë. Mësimi zhvillohej nga klasa e parë deri në klasën e katërt në një shkollë që e kishte ndërtuar pushteti i atëhershëm.

Nga viti në vit, numri i nxënësve sa vinte e rritej, kështu që ishte nevojë e domosdoshme që të ndërtohej një shkollë e re.

Organet e atëhershme shtetërore (që merrnin tatime të larta nga popullata vendore), në vitin **1925** ndërtuan objektin e ri shkollor me katër dhoma mësimi, me material të fortë ndërtimor dhe që për momentin i plotësonte nevojat dhe standardet për zhvillimin e procesit edukativo-arsimor.

Sipas statistikave të para të udhëhequra në shkollë, në vitin **1936/1937** shkolla kishte katër paralele nga kl. **I - IV** me gjithsejt **172** nxënës ku **1/3** e të cilëve, përkatësisht **57** nxënës ishin shqiptarë, kurse arsimtarët ishin të përkatësisë serbe.

Karakteristike e posaqme që ka përcjell shkollën tonë në këtë periudhë është moszgjidhja e çështjes nacionale dhe politika antishqiptare e asaj kohe, e cila ka çuar edhe në trajtimin jo të barabart të nxënësve shqiptarë karshi nxënësve të tjerë.

Kjo bëri që shumë nxënës shqiptarë të mbesin jashtë bankave shkollore.

Me fillimin e luftës së Dytë Botërore, në vitin **1941** ndërpritet puna në shkollë, për të rifilluar në vitin shkollor **1945/1946**.

Shtimi i vazhdueshëm i numrit të nxënësve që regjistroheshin dhe vijonin mësimet në shkollën fillore në Lipjan, imponoi nevojën për rregullimin e lokalit shkollor. Kështu në vitin shkollor **1949/1950** u bë ndërtimi i shkollës së re dhe për herë të parë në këtë vit shkollor filloi organizimi i mësimi në gjuhën shqipe, plotësisht i ndarë nga mësimi në gjuhën serbe.

Fillimisht mësimi në gjuhën shqipe zhvillohej si katër klasëshe dhe quhej **GJIMNAZI I ULËT** ose **PRO-GJIMNAZI**.

Drejtor i parë i kësaj shkolle u emërua **XHEVAT ALIU**, e krahas tij punonin edhe arsimtarët **HASAN SPAHIU, HASAN KRASNIQI, SHYQERI HAZIRI, ZENEL BALA, DIN MEHMETI, AGIM GJAKOVA**, etj.

Gjenerata e parë e semimaturantëve doli në vitin shkollor **1952/1953**. Këtë fatë e patën 37 nxënës.

Nga viti në vit numri i nxënësve sa vinte e rritej, sikurse edhe struktura kualifikuese e arsimtarëve që drejtpërdrejt ndikonte në ngritjen e cilësisë në punë. Kështu, nga bankat e shkollës sonë dolën shumë gjenerata të nxënësve të cilët më vonë bënë emër në shkollë dhe më gjerë.

Mirëpo, me rrënimin e autonomisë së Kosovës, në vitin **1989** fillojnë të vinë ditë të vështira për nxënësit dhe arsimtarët e shkollës sonë.

Nga organet e imponuara serbe bëheshin presione të mëdha që të pranoheshin planprogramet mësimore unike, të cilat e përdhosnin kulturën dhe identitetin tonë kombëtar.

Personeli arsimor shqiptar arriti t'iu bëjë ballë presioneve të vazhdueshme, duke shkëputur madje çdo bashkepunim me drejtorinë aktuale serbe dhe duke vu themelet e pavarësisht të sistemit arsimor shqiptarë.

Viti shkollor **1991/1992** është vit i vendimeve të mëdha dhe të rëndësishme për shkollën tonë.

Kështu, me **06.02.1992**, Këshilli i arsimtarëve mori vendim për caktimin e ushtruesit të detyrës së drejtorit të shkollës. Në këtë detyrë u emërua **DALIP ALIU** arsimtar i shkollës sonë. Pas kësaj, u vazhdua edhe më tej me institucionalizimin e shkollës sonë.

Me **02.04.1992** Këshilli i arsimtarëve mori edhe një vendim shumë të rëndësishëm dhe historik, duke emërtuar shkollën tonë me emrin: **Shkolla fillore “VËLLEZËRIT FRASHËRI” - Lipjan** dhe po me këtë emër u regjistrua në Ministrinë e Arsimit të Republikës së Kosovës, ku dhe u lëshua akti përkatës mbi regjistrimin e saj.

Të gjitha këto bënë që organet serbe të shkollës dhe ato komunale të marrin vendim për largimin me dhunë të nxënësve dhe punëtorëve shqiptarë nga objekti shkollor. Edhe pas shumë përpjekjeve të bëra nga punëtorët shqiptarë, por edhe nga prindërit për tu kthyer në objektet tona shkollore, organet serbe nuk lejuan kthimin në shkollë. Kështu, organet serbe mbyllën shkollën për nxënësit shqiptarë, por nuk mundën ta shuajnë dëshirën e shqiptarëve për dije e arsimim.

Prandaj, në vitin shkollor **1992/1993** u detyruam të kalojmë në objekte private, përkatësisht nëpër shtëpi-shkolla. Pra, shqiptarët hapen zemrat dhe shtëpitë e tyre për ta mbajtur gjallë fjalën dhe shkollën shqipe.

Në **Lipjan** shtëpitë e tyre i lëshuan: Hasim Ibrahim, Ejup Gashi, Hilmi Krasniqi, Hysen Bytyqi, Idriz Kongjeli, Halit Sejdiu, në **Lepi-Radevë**, Ramadan Qerkini, në **Hallaq i Madh** Shefqet Zeqiri, në **Jeta e Re**, Rexhep Stublla dhe Hafir Spahiu, në **Suhadoll** mësimi u organizua në shtëpinë e Osman Vehapit.

Me kushte të tilla të punës dhe me sakrificën e madhe të punëtorëve të arsimit, në lokale private shtëpi-shkolla u punua deri më **19.03.1999**, kur u nderpre mësimi për shkak të eskalimit të Luftës që po zhvillohej në mes të regjimit serb dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së).

Me të perfunduar lufta u kthyem në objektin shkollor. Ndodhi kjo me **26.06.1999**.